

Deri te:

Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të vendimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës nr. 13-1318/2 nga mbledhja e mbajtur më 03.10.2019, për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull: **“Sovraniteti dhe Legjitimiteti i Shtetit të Kosovës”**, të kandidatës Msc. Salihe Salihu, Komisioni në përbërje: Prof. Dr. Fehari Ramadani, Kryetar, Prof. dr. Fatmire Lumani, anëtar, Prof. Dr. Jusuf Zejneli, anëtar; Prof. Dr. Drita M. Fazliu, anëtar; Prof. Dr. Ylber Sela, Mentor, Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik i paraqet këtë:

RAPORT

Për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

Komisioni ka bërë analizën e disertacionit të kandidatës Salihe Salihu, me titull, **“Sovraniteti dhe Legjitimiteti i Shtetit të Kosovës.”**

Bazuar nga analiza-vlerësuese që i ka bërë Komisioni këtij disertacioni mund të përfundojmë se kandidatja në mënyrë të qartë ka arritur të paraqes çështjet si në vijim:

Lënda e disertacionit të temës Sovraniteti dhe Legjitimiteti i Shtetit të Kosovës është hulumtuar në mënyrë të duhur shkencore duke filluar nga zanafilla e çështjes së Kosovës, periudhat historike nëpër të cilat ka kaluar Kosova dhe populli i saj.

Kandidatja në mënyrë shkencore i bënë hulumtimin e informacioneve duke bërë një paraqitje me pikënisje historike të përmbledhur në mënyrë kronologjike e duke e përmbyllur me realitetin aktual të gjendjes në Kosovë.

Kandidatja ka përcaktuar edhe metodën e punës studimore duke zgjedhur metodën kualitative që i mundëson të bëjë analizë literaturës shkencoret të cilën e ka selektuar për ta përdorë përkëtë temë.

Në këtë mënyrë kandidatja me shkathtësi ka aplikuar metodën kualitative dhe ka arritur të ndërlihdë argumentet shkencore dhe mendimet asociative për temën duke studjuar ngjarjet dhe proceset politike që kanë qenë të determinuese për Sovranitetin dhe Legjitimitetin e Shtetit të Kosovës.

Puna studimore e këtij disertacioni është bërë në mënyrë analitike dhe kandidatja ka arritur që të zbërthej edhe konceptet Sovranitet dhe Legjitimitet -si dy variabla. Më tej kandidatja ka dhënë një pasqtrim argumentues për këto dy variabla të trajtuar nga aspekti historik, normat juridike e deri te parimet politike.

Nga këto këndvështrime kandidatja ka arritur që të nxjerrë në pah procesin historik të koncepteve sovranitet legjitimitet që në përputhje me modelin Westphalian ishin konstanta, pasi që siç sqaron kandidatja këto koncepte kishin karakter të përhershëm. Me këtë zbërthim të këtyre koncepteve kandidatja ka kontribuar që të kuptohet shkencërisht transformimi i tyre.

Në shpjegim të këtyre koncepteve kandidatja ka arritur të nënvizon arsyen substanciale të transformimit të tyre që në mënyrë të pa-kontestueshme kanë qenë të influencuar nga të drejtat e njeriut dhe e drejta e pupujve për vetëvendosje.

Kandidatja me qëndrim shkencor që karakterizohet me diopri neutraliteti e me objektivizëm ka arritur për të argumentuar shkencërisht se Sovraniteti dhe Legjitimiteti i shtetit të Kosovës ishte alternativa e vetme për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe për shpëtimin e popullit shqiptar nga shfarosja e regjimit serb.

Kandidatja në mënyrë të spikatur ka trajtuar temën nga perspektiva të ndryshme shkencore si në vijim: perspektivën historike, perspektivën juridike, perspektivën sociologjike por në veçanti dominon literatura nga perspektiva politike gjë që i përgjigjet edhe programit univeristar, gjegjësisht drejtimit: Sistemet Politike Bashkohore.

Duke u koncentruar në këto perspektiva, kandidatja ka kontribuar në trajtimin e të arriturave shkencore nga fillimi e deri në finalizim të procesit të sovranitetit dhe legjitimitetit, duke paraqitur të arritura më thelbësore që janë realizuar në shtetin e Kosovës. Kandidatja gjatë selektimit të literaturës përveç autorëve shqiptarë ka përdorur në masë të konsiderueshme edhe autorë të huaj, kryesisht autorë nga shtetet Perëndimor.

Me studimin e librave të autorëve të shumtë është qartësuar tërësisht tema e disertacionit duke ofruar një inkorporim të multi-perspektivave shkencore. Kandidatja ka arritur që në mënyrë specifike të shfrytëzoj për të punuar disertacionin me perspektivën e shkencave politike si perspektivë qendrore për inkorporimin e perspektivave tjera.

Shtjellimi i temës i paraqitur nga perspektiva historike dhe sociologjike ofron qartësim se çfarë alternativa ishin paraqitur si solucione për zgjidhjen e çështjes së Kosovës para se të shpërthente lufta në Kosovë në vitin 1998-të. Kandidatja kontribon në qartësimin e pikëqëndrimit se pse alterantiva e fundit për zgjidhjen e çështjes së Kosovës ishte që Kosova të shpallet si Shtet i Pavarur dhe Sovran.

Me këto argumentime kandidatja paraqet në mënyrë të thukët momentumin e kësaj ngjarje si pjesë e ndryshimeve që kishin ndodhur në rajon dhe më gjërë nga aspektet historike, sociale, juridike e politike.

Kandidatja në pasqyrimin e temës me perspektivat e lartë përmendura ka trajtuar si faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Si faktorë të jashtëm përveç qëndrimeve të aktorëve ndërkombëtar rreth status-quoos së Kosovës kandidatja ka trajtuar edhe Konventa e Rezoluta Ndërkombëtare që kanë afektuar në çështjen e zgjidhjes së çështje së Kosovës.

Rrjedhimisht kandidatja ka trajtuar dokumentet e rëndësishme të Kosovës dhe të ish-federatës jugosllave që preknin drejtpërdrejt status-quoon e Kosovës. Poashtu edhe vendimet si dhe Rezolutat Ndërkombëtare rreth status-quoos së Kosovës që janë nxjerrë nga instancat më të larta ndërkombëtare siç njihet Organizata e Kombeve të Bashkuara janë pjesë e trajtimit në këtë disertacion.

Kandidatja, gjithashtu, ka analizuar Vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) që ka dhënë përgjigjien përfundimtare për solucionin përfundimtar të çështjes së Kosovës si Shteti Sovran dhe Legjitim.

Në pasqyrim të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) kandidatja në mënyrë brilante ka shqyrtuar opcionet e mundshme që kishte GJND-ja për përgjigjie, ndaj kërkesës së parashtruar nga ana e qeverisë së Serbisë, se a ishte akti i shpalljes së pavarësisë së Kosovës në harmoni me të Drejtën Ndërkombëtare.

Kandidatja në mënyrë shkencore i trajton parimet e GJND-së mbi të cilat ka pushuar fuqishëm vendimi i GJND-së për rastin e Kosovës. Me këto sqarime kandidatja kontribon që të jep shpjegime shkencore se në cilat parime ishte bazuar GJND-ja dhe sjell të pasqyruar vendimin përfundimtar të GJND-së si një vendim që është Dokument Normativ Final për Legjitimitetin dhe Sovranitetin e Shtetit të Kosovës.

Në përfundim të konkluzioneve tona, si anëtarë të Komisionit, konkludojmë se Kandidatja në mënyrë shkencore ka kontribuar në argumentimin e të drejtës së Sovranitetit dhe Legjitimitetit të Kosovës si alternativë e vetme për zgjidhjen e çështjes së Kosovës.

Me analizë të elaboruar mirë kandidatja ka kontribuar që rasti i Kosovës të argumentohet shkencërisht duke përpunuar procese historike që ndikuan në status-quon e Kosovës. Më pastaj kandidatja në analizë involvon aspektet sociologjike që tregonin për jetën e shqiptarëve para luftës së vitit 1998-të si dhe pas kësaj periudhe.

Në kompletim të kësaj analize kandidatja vazhdon me aspektet juridike që në mënyrë shkencore paraqiten me shkelje brutale të qeverisë së Serisë ndaj të drejtave të popullit shqiptar për të jetuar të lirë. Në mënyrë argumentuese kandidatja paraqet të drejtën e patjetërsueshme të popullit shqiptar si dhe spjegon edhe përkrahjen e ndërkombëtarve dhe ndërhyrjen e NATO-s për ta shpëtuar popullin shqiptar.

Poashtu kandidatja e argumenton shkencërisht arsyjen humanitare të përkrahjes ndaj kërkesave të shqiptarëve nga faktorit ndërkombëtarëve në luftën e Kosovës. Më tej, kandidatja ka argumentuar se përkrahja e shteteve demokratike në luftën e Kosovës ishte në harmoni me legjitimitetin moral e etik mbi të cilat është ndërtuar sistemi ndërkombëtar.

Gjithashtu, në analizën e kësaj teme ne mund të konkludojmë që kandidatja kontribon të paraqesë në mënyrë argumentuese se sa është Sovran dhe Legjitim Shteti i Kosovës. Duke dhënë përgjigje në këtë dimension kandidatja kontribon për paraqitjen e realitetit të sotëm të shtetit të Kosovës si Shtet Sovran dhe Legjitim.

Në përshkrimin e shkurtë të rezultateve të hulumtimit vlerësojmë se kandidatja ka arritur të analizojë rrymat e ndryshme që kanë ekzistuar në Kosovë gjatë përpjekjeve të popullit shqiptarë për pavarësi, duke respektuar çdo segment të këtyre orvajtjeve, ku fillimisht paraqet

orvajtjen e popullit shqiptar për të qenë Republikë dhe për të fituar të drejta të barabarta me popujt tjerë të ish federatës Jugosllave, luftën paqësore të popullit shqiptarë për një dekadë, luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, periudhën pas Clirimit të Kosovës, periudhën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës e deri në ditët e sotme.

Përmes trajtimit të aspekteve normative, kandidatja ka arritur në mënyrë shkencore të paraqet apartheidin shtetëror të ushtruar të ish-federatës jugosllave kundër popullit shqiptar të Kosovës. Kandidatja, ka arritur të argumentoj shkeljet kushtetutare që ushtronte pushteti serb kundër popullatës shqiptare.

Kandidatja, nga perspektiva e shkencave politike si perpektivë qendrore në këtë trajtesë ka arritur të shtjellon shkencërisht konceptet sovranitet dhe legjitimitet duke i inkooporuar me Sovranitetin dhe Legjitimitetin e Shtetit të Kosovës.

Në një dimension të veçantë kandidatja ka arritur të pasqyroj edhe ndihmën e ndërkombëtare, në veçanti intervenimin e NATO-s si dhe rolin e organizatave jo-qeveritare si gjatë periudhës para luftës dhe pas luftës së vitit 1999-të.

Me kapacitetin e një studjuese shkencore, kandidatja ka arritur të argumenton se Sovraniteti dhe Legjitimiteti i Shtetit të Kosovës ishte alternative e vetme për shpëtimin e popullit shqiptarë nga nga rreziku i shfarosjes. Rrjedhimisht, kandidatja argumenton se Sovraniteti dhe Legjitimiteti i Shtetit të Kosovës ishte një e drejtë legjitime e garantuar edhe me akte ndërkombëtare.

Në këtë trajtim të temës së doktoraturës kandidatja ka arritur që të pasqyron edhe realitetin pas shpalljes së Sovranitetit dhe Legjitimitetit të Shtetit të Kosovës duke ofruar të dhëna argumentues në fuqizimin e sovranitetit dhe legjitimitetit të tij.

Në këtë dimension, kandidatja paraqet parametrat e shtetëndërtimit dhe përpjekjet për të fuqizuar shtetin e Kosovës, si brenda vendit ashtu edhe në relacion me Bashkësinë Ndërkombëtare.

Kandidatja, ka arritur që në këtë temë të disertacioni ta pasqyrojë në mënyrë shkencore të kaluarën e popullit shqiptar të Kosovës, vuajtjet dhe përpjekjet për të ndryshuar statusin e tyre gjatë një periudhë të gjatë kohore. Gjithashtu në analizë të kësaj teme është përfshijë edhe

periudha pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës duke prezentuar gjendjen e aktuale të shtetit të Kosovës.

Në përmbyllje të konkluzioneve tona përfundimtare konstatojmë se kandidatja me këtë temë të disertacionit ka kontribuar që të shtrojë edhe proceset dhe sfidat që e presin shtetin e Kosovës në të ardhmen.

Ndërkaq, në propozimet që kandidatja jep për hulumtime të mëtejshme në këtë fushë nënvizohet se për studjues të ardhshëm është i mundur argumentim më i gjërë për Legjitimitetin moral e normativ të intervenimit të NATO-s në rastin e Kosovës.

Kandidatja supozon se ende nuk është shtjerruar argumentimi shkencor në këtë dimension. Kandidatja propozon që të hulumtohet rreth argumenteve e fakteve rreth intervenimit të NATO-s në Kosovë dhe të studjohen në këndvështrim me zakonet e të Drejtës Ndërkombëtare.

Kandidatja presupozon që kjo temë mund të hulumtohet edhe nga këndvështrimi i sistemit të politikave bashkëhore duke u fokusuar në disa aspekte që konsiderohen si dimensione të nevojshme rreth hulumtimit të mundshëm rreth kësaj teme. Prandaj, kjo temë mund të zgjerohet duke pasqyruar edhe levërditë apo dëmët që ka sjellur intervenimi i NATO-s. Me këto propozime kandidatja presupozon se përmes ndonjë hulumtimi të ri mund të ndriqohen dhe të verifikohen rezultatet pozitive dhe negative të intervenimit të NATO-s duke e shikuar nga këndvështrimi i qëndrueshmërisë, stabilitetit dhe paqjes rajonale si rezultatet final nga intervenimi.

Në fund ne si komision kemi ardhë në përfundim se kandidatja me sukses të lartë ka arritur që të jep përgjigje shkencore në të gjitha hiptezat dhe pyetjet e shtruara në këtë temë të disertacionit me titull Sovranitetit dhe Legjitimiteti i Shtetit të Kosovës.

Gjithë anëtarët e komisionit janë të unifikuar në vlerësimin e rrjedhur nga analiza e këtij disertacioni me propozim përfundimtar që kandidatja i ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara për pranimin e këtij disertacionit si një punim shkencor me notën më të lartë.

Me këtë propozim përfundimtar ne si anëtarë të Komisionit e paraqesim kandidaten ka përgatitje të duhur për mbrojtjen e tezës së disertacionit: Sovraniteti dhe Legjitimiteti i Shtetit të Kosovës.


Prandaj, si Komision, i rekomandojmë Këshillit Mësimor të Fakultetit Juridik që të miratoj këtë raport final të këtij disertacioni.

KOMISIONI:

1. **Prof. dr. Fehari Ramadani, Kryetar**



2. **Prof. dr. Fatmire Lumani, anëtar**



3. **Prof. dr. Jusuf Zejneli, anëtar**



4. **Prof. dr. Drita M. Fazlija, anëtar**



5. **Prof. dr. Ylber Sela, Mentor**

